REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr 272/1 Prot

Lushnje më 10/01/2025

**PROJEKT -VENDIM**

Nr 08 Datë 10.01.2025

**"MBI MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT TË KAPITALIT NATYROR NË BASHKINË LUSHNJE"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/__/_____, pasi analizoi relacionin e paraqitur "Mbi miratimin e dokumentit të Vlerësimit të Kapitalit Natyror", si dhe në zbatim të në zbatim të ligjit nr:139/2015, datë 17.02.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", neni 9 pika1.2 shkronja "c", neni 16, neni 27, 28, 34, 35 pika 5 shkronja "b", neni 36, 37, 54 shkronja "k", Ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore", neni 19 pika 1,3,4, Ligjit Nr:9244, date 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" i ndryshuar, Ligji 57/2020 "Për Pyjet", neni 11, pika 2, shkronja c, neni 12, neni 17. Këshilli Bashkiak :

**PROPOZOJ:**

1- Të miratojë dokumetin e "Vlerësimit të Kapitalit Natyror në Bashkinë Lushnje".

2- Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**N/KRYETARI I BASHKISË**
**Elton KORRESHI**

**DREJTORI JURIDIK**
**Bedri HIDA**

**KRYETARI I BASHKISË**
**Eriselda SEFA**

Adresa: Lagjia Kongresi Lushnje Tel:+355 35 22139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com



# VLERËSIMI I KAPITALIT NATYROR

BASHKIA LUSHNJE

OSCE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

# VLERËSIMI I KAPITALIT NATYROR

BASHKIA LUSHNJE

Studimi u mbështet në Metodologjinë e Vlerësimit të Kapitalit Natyror të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri.

**www.osce.org/albania**

**Grupi i Punës i Bashkisë Lushnje nën drejtimin e Z. Elton Korreshi, N/Kryetarë i Bashkisë;** dhe anëtarë :

**Z.** Niko Ferro, Përgjegjës i Turizmit; Znj.Elda Prifti Specialiste për Vlerësimin e Detyrimit (Biznesi Madh) në Drejtorin e të Ardhurave Vendore; Znj. Irena Sinani, Specialiste për Mbrojtjen e Mjedisit në Sektorin e Mjedisit; Z. Erjon Hasani, Përgjegjës Sektori Pyjeve dhe Kullotave; Znj.Irina Beshiri Specialiste per Inventarizimin e Aseteve dhe Monitorimi i Kontratave në Sektorin e Aseteve; Znj. Floriana Tusha Specialiste në Sektorin e Konflikteve të Tokës Bujqësore, Drejtoria e Zhvillimit Rural. Znj. Enva Kruja, Specialist për Ligjshmërinë, Sektori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Këshillimit Bujqësor në Drejtorinë e Zhvillimit Rural

# TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE ..... 7
1.1 Qëllimi dhe objekti i raportit ..... 7
1.2 Metodologjia ..... 8
2 PROFILI I BASHKISË LUSHNJE ..... 10
2.1 Pozita gjeografike ..... 10
2.2 Kapitali Natyror në Bashkinë Lushnje ..... 12
2.3 Infrastruktura e ujitjes ..... 13
2.4 Monumente kulturore dhe natyrore ..... 14
2.5 Kapitali njerëzor në Bashkinë Lushnje ..... 21
2.6 Kapitali Social në Bashkinë Lushnje ..... 21
2.7 Kapitali i prodhuar në Bashkinë Lushnje ..... 22
2.8 Kapitali financiar i Bashkië Lushnje ..... 22
2.9 Sistemet territoriale ..... 23
3 IDENTIFIKIMI I BURIMEVE NATYRORE ..... 23
3.1 Burimet minerare ..... 23
3.2 Burimet ujore ..... 27
3.3 Atraksionet turistike ..... 28
3.4 Pyjet ..... 30
3.5 Bujqësia dhe blegtoria ..... 31
3.6 Biodiversiteti ..... 38
4. VLERËSIMI MONETAR I BURIMEVE NATYRORE ..... 41
4.1 Burimet minerare ..... 41
4.2 Burimet ujore ..... 43
4.3 Pyjet ..... 44
4.4 Bujqësia dhe blegtoria ..... 47
4.5 Biodiversiteti ..... 51
5. Përfundime dhe rekomandime ..... 52




## PËRMBLEDHJE KRYESORE

Bashkia Lushnje ka në dispozicion një larmishmëri të llojeve të kapitalit natyror (KN) duke përfshirë burimet minerare, burimet ujore, pyjet dhe kullotat, tokat bujqësore, burime energjitike të rinovueshme, zona natyrore me potencial turistik dhe rekreacioni si edhe me një biodiversitet të pasur mes florës dhe faunës.

Në bazë të analizës së realizuar, fluksi vjetor monetar nga KN në bashkinë Lushnje shtë rreth 22,275,015,680 lekë, ndërsa aktivi monetar llogaritet rreth 441,244,035,559 lekë. Vendin kryesor në vlerën e kapitalit e zënë prodimet bujqësore ara perime, por vlera e rezervave të naftës zë një vend të rëndësishëm në vlerën e aktivit monetar.

Kapitali natyror Lushnje



# 1. HYRJE

Ky raport është vlerësimi i kapitalit natyror të bashkisë Lushnje. Synimi i këtij raporti është të krijojë një vlerësim bazë të kapitalit natyror në bashki dhe të trajtojë çështjet e grumbullimit, aksesit dhe analizës së të dhënave në nivel bashkie. Nevoja për këtë raport rrjedh nga mungesa e një vlerësimi rutin për gjendjen e kapitalit natyror dhe aftësisë së tij për të mbështetur shërbimet kritike të ekosistemit në nivel vendor. Sot, teknikat moderne që ekzistojnë përgjatë një larmie të gjerë disiplinash, e bëjnë të mundur një analizë të kapitalit natyror.

Ky raport bën të mundur lidhjen e kapitalit natyror në bashkinë Lushnje me llogaritë kombëtare dhe mundëson një kuadër për të kuantifikuar vlerën e kapitalit.

Raporti është i bazuar në një metodologji të hartuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri për "Vlerësimin e Kapitalit Natyror". Duke ndjekur linjën metodike, raporti është i ndërtuar në tre kapituj kryesor: i) kapitulli i parë paraqet një profil të përgjithshëm të Bashkisë Lushnje në këndvështrimin social- ekonomik, mjedisor, historik dhe kulturor; ii) në kapitullin e dytë të raportit prezantohet një hartëzim i gjithë elementëve sasior dhe cilësor të kapitalit natyror në Bashkinë Lushnje në kapitullin e tretë paraqitet vlerësimi monetar i kapitalit natyror të Bashkisë Lushnje bazuar në të dhënat sasiore të paraqitura nga Grupi i Punës së bashkisë.

## 1.1 QËLLIMI DHE OBJEKTI I RAPORTIT

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të trajtojë pyetjet e mëposhtme: Kush është kapitali natyror në bashkinë Lushnje dhe kush është vlera ekonomike, monetare e këtij kapitali? Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, ky raport ka si objekt:

- Të zhvillojë një inventar të detajuar sasior dhe cilësor të kapitalit natyror në bashkinë Lushnje duke analizuar gjithë potencialin e mundshëm kërkimor, statistikor përgjatë një sërë sektorësh;
- Të vlerësojë vlerën monetare të këtij kapitali duke përdorur formula dhe metodologji specifike sipas legjislacionit në fuqi për elementët e kapitalit;
- Për të zbatuar këto objektiva, projekti i mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe bashkinë Lushnje ka kryer këto detyra:
- Shqyrtim të literaturës dhe punë kërkimore;
- Shqyrtim të listës së aseteve dhe kapitalit natyror të paraqitur nga Grupi i Punës i krijuar në nivel bashkie;
- Organizimin e një takim teknik me Grupin e Punës së bashkisë Lushnje për të diskutuar mbisfidën e mbledhjes së statistikave, mënyrën e përllogaritjes dhe burimet e informacionit;

## 1.2 METODOLOGJIA

Ky raport është bazuar në metodologjinë e hartuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri së bashku me Ministrinë e Brendshme (OSCE & MB, 2021). Referuar kësaj metodologjie, është bërë i mundur përcaktimi i "përkufizimit" dhe kuadrit të kapitalit natyror, me punën e një sërë ekspertësh nga disiplinatë ndryshme. Figura 1, më poshtë prezanton qasjen skematike të procesit të kryerjes së vlerësimit të kapitalit natyror, bazuar në metodologji.





*Figura 1. Qasja skematike dhe metodike për kryerjen e kapitalit natyror.*

Në këtë kontekst, metodologjia e ndjekur për këtë raport ka qenë si më poshtë:

### KRIJIMI I GRUPIT TË PUNËS:

Me urdhër të kryetares së bashkisë u krijua grupi i punës në nivel bashkie. Grupi i punës përbehej nga specialistë të sektorëve kyç për kapitalin natyror si: mjedisi, turizmi, bujqësia, pyjet, ujërat, taksat, energjia dhe burimet, por edhe nga zyra të tjera shërbimesh vendore, brenda dhe jashtë bashkisë.

### GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE.

Grupi i punës, së pari mbështetur në metodologjinë filloi të grumbulloi të dhëna me qëllim popullimin e databazës për të bërë një analizë sa më të plotë për KN të bashkisë. Mbledhja e të dhënave ishte një sfidë që u arrit të tejkalohej, duke përdorur të gjitha burimet nga institucione vendore, rajonale dhe kombëtare. Përpunimi i të dhënave u përqendrua në sasinë, cilësinë dhe vendndodhjen e aseteve të KN.

## PËRGATITJA E RAPORTIT PARAPRAK.

Raporti është përgatitur hap pas hapi sipas metodologjisë. Për çdo hap përgatitej një draft nga bashkia në konsultim dhe asistencën e ekspertëve të fushës. Më tej, draftit për çdo hap i rishikoheshin dhe verifikoheshin të dhënat nga burime të ndryshme.

## KONSULTIMI.

Raporti paraprak u konsultua fillimisht së brendshmi nga grupi i punës, i cili më pas e konsultoi atë me aktorë të tjerë dhe sidomos me siguruesit e të dhënave. Më pas raporti paraprak u konsultua me përfaqësues vendor, përfaqësues të njësive administrative dhe fshatrave.

## PËRFUNDIMI DHE MIRATIMI I RAPORTI NGA BASHKIA.

Raporti mbi KN, i strukturuar sipas metodologjisë, ka kaluar disa filtra në tërë prezantimin e tij. Pjesa narrative dhe ajo me të dhëna mbi llogaritë financiare, funksionet dhe vlerësimin e çdo aseti, ishte objekt i trajtimit të konsultimeve të gjëra profesionale dhe statistikore. Miratimi i parë informal i raportit ka kaluar nga grupi i punës në bashki dhe më pas raporti ka marrë edhe një miratim formal nga kryetarja e bashkisë.



# 2 PROFILI I I BASHKISË LUSHNJE

## HULUMTIME PËR LASHTËSINË E QYTETIT TË LUSHNJËS

Dokumenti më i hershëm historik i zbuluar deri më tani, e citon Lushnjën si qendër banimi që i përket shek. XV. Por që me siguri Lushnja duhet të jetë themeluar më herët se kaq. Sipas dokumentit osman i cili daton në vitin 1431, vit në të cilin u bë dhe regjistrimi i dokumentuar i popullsisë së Myzeqesë. Myzeqeja në atë kohë kishte 33 fshatra dhe 58 familje ndërsa "Lusnia" (Lushnja) që në këtë periudhë ishte një katund i vogel, na del me 15 shtëpi dhe rreth 100 banorë. Ajo përmendet përsëri me të njëjtin emër, në një tjetër defter osman që mban datën më 1583.
Mësojmë nga burimet historike se Lushnja në vitin 1679 *kishte 17 hane dhe me një popullsi afërsisht 150 banorë.*
Fillimi i vitit 1701 e gjen Lushnjën me një popullsi të dyfishuar, por ajo ruante akoma karakterin e një fshati. Midis viteve 1728-1738 mendohet te jetë ndërtuar kisha Shën e Premtes. Në këtë periudhë Lushnja përmëndet si Çiflig. Disa vite më vonë (1741), Sanxhaku i Vlorës përfshiu të gjithë Shqipëtaret e jugut nga Shkumbini deri në Delvinë. Kazaja e Myzeqesë varej nga ky sanxhak. Trojet e Lushnjës dhe të rrethinave të saj, u thirrën Nahija e Myzeqesë, qendër e së cilës u bë fshati Karbunarë. Në vitin 1744 Lushnja paraqitet si katund me 57 shtëpi dhe rreth 500 banorë, ndërsa Karbunara na paraqitet me 47 shtëpi. Në këtë periudhë Lushnja morri pamjen e një qyteze të vogël, ajo kishte një kishë dhe dy rrugë të shtruara me kalldrëm. Afërsisht në vitin 1770, me nismën dhe mbështetjen e gruas së Kurt Pashës, Hanko Pasha, ngrihet xhamia e parë në Lushnje e cila ka ekzistuar deri në vitin 1967. Lushnja përgjat gjithë shekullit XVIII fillon gradualisht të zgjerohet dhe të marrë pamjen e një qëndre të rëndësishme banimi dhe tregtie.
Në vitin 1830, Lushnja citohet për herë të parë në Fjalorët enciklopedik evropian. Aty thuhet se "Lusnia" ka 200 shtëpi dhe është e banuar si nga myslimanët dhe të krishterët. Pra në vetëm një shekull kemi një trefishim të popullsisë e cila mund të shkonte afërsisht në 1800 banorë. "
Në vitin 1860 në Lushnjë u hap shkolla e parë, ku përveç mësimit të gjuhës greke, mësohej shqip në mënyre të fshehte. Shkolla në fjalë ka qenë ngritur afër kishës Shën e Premte. Po në vitet 1860-1870 në Lushnje u hap dhe shkolla Mejtepe (shkolle fillore fetare osmane), ndërsa në Karbunare ishte e hapur një tjeter shkollë mejtepe pak vite më parë se ajo e Lushnjës.
Pas vitit 1870 Lushnja filloj të dallohej si qendër dhe të marrë pamjen e një qyteti. Në këtë periudhë mendohet të jetë ndërtuar teqja e "Baba Skënderit".
Në vitin 1894-1896 Qëndra e Kazasë së Myzeqesë (nënprefektura), kaloi nga Karbunara në Lushnje.

## POZITA GJEOGRAFIKE

Bashkia Lushnje bën pjesë në Qarkun Fier dhe ka si qendër të saj qytetin e Lushnjes. Ajo kufizohet në veri me Bashkinë e Rrogozhinës, në verilindje me Bashkinë e Peqinit, në lindje me Bashkinë e Belshit, në juglindje me Bashkinë Dimal, në jug me Bashkinë e Roskovecit, në jugperëndim me Bashkinë e Fierit dhe në perëndim me Bashkinë e Divjakës. Bashkia ka një sipërfaqe prej 379.58 km² dhe ka në përbërje të saj 11 njësi administrative, të cilat janë: Lushnje, Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem, Dushk, Karbunarë, Ballagat, Fier-Shegan, Kolonjë dhe Krutje. Bashkia Lushnje ka një popullsi sipas regjistrit të Gjendjes Civile 132 068 banorë dhe 63 135 banorë sipas Censusit 2023.

Nga pikëpamja e infrastrukturave rrugore të sotme, Bashkia Lushnje vazhdon të k etë një pozicion mjaft të favorshëm gjeografik dhe strategjik si për shkak te pozicionimit ndërmjet dy pikave më të rëndësishme p o r t e v e t ë Vlorës dhe Durrësit, ashtu edhe për arsye se në këtë territor kalojnë Korridori VIII dhe Korridori i Kaltër, të cilët, së bashku me Korridorin Durrës- Nish, përbëjnë korridoret më të rëndësishme të Shqipërisë.

Lushnja gjendet ne perëndim të Shqipërisë, pikërisht në të ashtuquajturën Ultësira Perendimore. Karakterizohet nga një reliev i butë, me pjesën dërrmuese te sipërfaqes të zënë nga fusha dhe kodra që shkojnë deri në 200 m lartësi mbi nivelin e detit në zonën verilindore dhe në zonën e Kolonjës. Zona fushore ka lëvizje të lartësisë nga 2.5 deri në 52 m mbi nivelin e detit dhe njihet për prodhimtarinë e madhe bujqësore. Kjo zonë bën pjesë në fushën e Myzeqesë dhe njihet për numrin e madh të serrave dhe rrjetin e pasur me kanale vaditëse. Fusha e Muzeqesë është ndër fushat më të mëdha në Republikën e Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë ka edhe prodhimtarinë më të madhe.

## 2.1 NDARJA TERRITORIALE E BASHKISË LUSHNJE

Bashkia Lushnje përbëhet nga 11 njësi administrative Lushnje, Allkaj Ballagat, Dushk, Fieshegan, Golem, Hysgjokaj, Krutje, Karbunarë, Kolonjë. Territori i bashkisë së Lushnjes shtrihet në fushën e Myzeqesë e cila përbën një burim natyror të rëndësishëm dhe potencial për zhvillimin ekonomik. Në territorin e saj gjen zhvillim monoklinali i Patos – Marinzë – Bubullimë. Sektorët që ofrojnë punësim për banorët e zonës janë, sektori i ndërtimit, bujqësia, blegtoria dhe pemëtaria.

Bashkia Lushnje së bashku me bashkitë Fier, Mallakastër, Divjakë, Patos dhe Roskovec janë pjesë e Qarkut Fier. Bashkia Lushnje nga shtrirja dhe popullsia është bashkia e dytë më e madhe në këtë qark.




Tabela e përbërjes territoriale e Bashkisë Lushnje

| Njësitë Administrative | Lagjje / Fshatra |
|---|---|
| Lushnje | Lagjja Ç'lirimi", Lagjja "Kadri Qystri", Lagjja "Kongresi Lushnjes", Lagjja "Xhevdet Nepravishta", Lagjja "Loni Dhamo", Lagjja "Skënder Libohova", Lagjja "Gafurr Muço", Lagjja "18 Tetori", Lagjja "Karbunarë", Lagjja "Savër". |
| Allkaj | Allkaj, Toshkëz, Biçakaj i Vjetër, Delisufaj, Zhelizhan, Lifaj i Ri, Mazhaj , Çukas i Ri. |
| Ballagat | Manasufaj, Gjuzaj, Gjyshaj, Garunjas, Jazexhi, Xibrakë |
| Bubullimë | Bubullimë, Eskaj, Gjonas, Pirrë, Kamçisht, Halilaj, Imësht. |
| Dushk | Dushk i Madh, Dushk Peqin, Zhamë Sektor, Zhamë Fshat, Konjat Thanasaj. |
| Fiershegan | Fiershegan, Kosovë e Vogël, Barbullinjë, Koçaj, Jeta e Re, Çinar, Thanë, Murriz Kozare, Çukas i Vjetër, Sejmenas, Qerret i Vjetër, Qerret i Ri, Biçakaj i Ri. |
| Golem | Golem i Madh, Golem i Vogël, Allprenaj, Plug, Hajdaraj, Shegas. |
| Hysgjokaj | Hysgjokaj, Kurtinë, Çanakaj, Kupas, Lekaj. |
| Karbunanarë | Karbunarë e Sipërme,, Stan Karbunarë, Kashtëbardhë, Mollas, Kassharaj , Zgjanë, Balaj, Biçakaj, Murriz Peqin , Skilaj. |
| Krutje | Krutje e Sipërme, Krutje e Poshtme, Fier i Ri, Zhymë, Lifaj i Vjetër, Rupaj, Kadiaj, Ngurrëz e Madhe , Ngurrëz e Vogël, Arrës, Gjazë. |
| Kolonjë | Kolonjë, Bishqethëm, Gorre, Lumth, Rrapëz Fshat, Rrapëz Sektor, Shakuj, Ardenicë, Bitaj, |

## 2.2 KAPITALI NATYROR I BASHKISË LUSHNJE

Bashkia e Lushnje si pjesë integrale e territorit të Qarkut Fier, ndodhet në pjesën perëndimore të vendit në një terren kodrinor të ulët dhe fushor (pjesë e fushës së Myzeqesë), ndodhet në lindje të fushës së Myzeqesë,

Terreni i bashkisë Lushnje është kryesisht fushor, me kodra që shkojnë deri në 200 m lartësi mbi nivelin e detit në zonën verilindore dhe në zonën e Kolonjës. Zona fushore ka lëvizje të lartësisë nga 2.5 deri në 52 m mbi nivelin e detit dhe njihet për prodhimtarinë e madhe bujqësore. Kjo zonë bën pjesë në fushën e Myzeqesë dhe njihet për numrin e madh të serrave. Fusha e Myzeqesë është ndër fushat më të mëdha në Republikën e Shqipërisë.

Drejtimi kryesor i zhvillimit në Bahkinë Lushnje është bujqësia e cila po luan një rol të rëndësishëm jo vetë në tregun e brendshëm por edhe atë të jashtëm, ku eksportet e prodhimeve bujqësore janë vazhdimisht në rritje. Prandaj dhe bujqësia ka qenë fokusi i investimeve me qëllim rritjen e prodhimeve bujqësore. Zhvillimi i begtorisë ka mundësuar aktivitetin e disa kompanive të përpunimit të qumështit.

Hidrografia në Bashkia Lushnje përbëhet nga lumi Seman dhe lumi Shkumbin, Rezervuari i Thanës, Rezervuari i Kasharajt dhe një numër i konsiderueshëm rezervuarësh gjithashtuu kemi një rrjet të gjerë kanalesh ujitës.



## 2.3 INFRASTRUKTURA E UJITJES - REZERVUARËT

### HIDROGRAFIA

Territori i bashkisë Lushnje kufizohet nga rrjedhat e dy lumenjve kryesorë. Në veri të territorit kemi kalimin e lumit Shkumbin, ndërsa në juglindje, në kufirin me bashkitë Roskovec dhe Dimal, kemi rrjedhën e lumit Seman. Përveç lumenjve kemi edhe disa rezervuare dhe liqene, si: rezervuari i Thanës, Rezervuari i Kasharajt, Rezervuari i Lushnjes. Ia vlen, gjithashtu, të përmendim edhe kanalet vaditëse, të cilat shtrihen përgjatë pjesës fushore. Ndër këto kanale mund të përmendim tri më të rëndësishmet, të cilat dalin nga rezervuari i Thanës: kanalin Emisar, kanalin përgjatë Semanit, si dhe kanalin që shkon drejt veriut përmes qytetit të Lushnjes. Për më tepër, në qytetin e Lushnjes kemi edhe rrjedhën e përroit të Lushnjes, i cili buron nga Rezervuari i Kasharajt. Ky përrua ka luajtur rol edhe si element i fortë i qytetit të Lushnjes, duke ndikuar në zhvillimin territorial të tij

### REZERVUARËT:

Bashkia e Lushnjes ka një numër të konsiderueshëm rezervuarësh të cilët përqëndrohen kryesisht në pjesën veri-lindore të territorit ndërmjet vendbanimeve Lushnje, Thanasaj, Dushk-Peqin dhe Manasufar në skajet më veriore dhe Hysgjokaj, Biçakaj dhe Kosovë e Vogël në skajin lindor. Ndër rezervuarët më të mëdhenj përmenden:

- Rezervuari i Murrizit /Thanës: ky rezervuar ndodhet në pjesën lindore të bashkisë dhe shërben si kufi me Bashkinë e Kuçovës. Rezervuari është i përbashkët me Bashkinë e re të Belshit.
- Rezervuari i Kasharit i cili ndodhet në lindje të qytetit të Lshnjës, i shtrirë në pjesën kodrinore të bashkisë.

- Rezervuari i Lushnjes i cili shtrihet në pjesën lindore të bashkisë së re dhe shërben si kufi ndarës me bashkinë e Belshit. Më konkretisht, ky rezervuar shtrihet ndërmjet fshatrave Kupaj në veri dhe Murriz-Peqin në jug.
- Rezervuarë të tjerë: rezervuarët e tjerë në territorin e bashkisë gjenden në afërsi të fshatit Gjyshaj, Shegas, Dushk-Peqin, Matjan, Manasufaj dhe ndërmjet fshatrave Kurtinë dhe Hysgjokaj.

### RRJETI I KANALEVE VADITËSE-KULLIMI:

Bashkia bën pjesë në Ultësirën Perëndimore të vendit, e cila dallohet për nivel të barabartë lartësie me nivelin e detit si dhe për një sipërfaqe të konsiderueshme moçalore. Një pjesë e mirë e kësaj sipërfaqeje është tharë për t'u përdorur për bujqësi në vitet përpara '90-ës. Sot, tokat e nxjerra nga tharja e kënetave japin prodhime të larta bujqësore. Për përdorimin e tyre për bujqësi, janë hapur një numër i madh kanalesh për ujitje dhe kullim, të domosdoshëm për përdorimin e këtyre tokave për bujqësi. Me përjashtim të zonës veri-lindore, i gjithë territori i bashkisë së re mbulohet nga rrjeti i vaditës-kullimit.

## 2.4 MONUMENTEVE KULTURORE DHE NATYRORE

### MONUMENTE KULTURORE

#### MANASTIRI I ARDENICËS

Studiuesit më në zë të monumenteve të kulturës në Shqipëri theksojnë se manastiri është ndërtuar në mesjetën e mesme. Sipas një gojëdhëne themelet e këtij manastiri janë hedhur në vitin 1282 me nismën e perandorit Andronik II Paleolog të Bizantit. **Gojëdhëna tjetër** e identifikojnë atë si vendin ku është mbajtur kurorëzimi i Gjergj Kastriot Skënderbeut me Donika Arianitin në pasditen e datës 26 prill 1451. Ndërsa mbishkrimi që mban datën 1 Maj 1477 mbi portën hyrëse dëshmon për ekzistencën e manastirit në këtë periudhë. Në fakt, ndërhyrjet restauruese që janë bërë në monument në fillim të viteve '80, treguan se manastiri ka njohur disa faza ndërtimi. Arkeologët arritën në përfundim se faza më e hershme e ndërtimit lidhet me kishën e "*Shën Triadhës*", themelet e së cilës janë **në një nivel me një varr të datueshëm në shek X.** Në këtë kontekst vlejnë të përmendim se **në anën perëndimore të kodrës ku ngrihet manastiri, janë zbuluar gjurmët e rrugës së vjetër** *Egnatia*, tjegulla dhe kapitele të Antikitetit të Vonë si dhe enë Mesjetare.



**Manastiri i Ardenicës**

## KISHËZA E "SHËN TRIADHËS"

Është një ndërtesë e vogël një nefëshe me përmasa 7, 50 x 3, 70 m së cilës nga ana lindore i ngjitet volumi i një stere uji. Hyrjen ajo e ka në anën perëndimore. Brendësia e kapelës ndriçohet nga dy dritare të vogla në murin jugorë. Përmasat e brendshme janë 5.15 x 3.06 m. Nga ana veriore kapelës i mbështeten dhomat e manastirit, duke lënë në këtë mënyrë të lira faqen perëndimore dhe jugore. Kisha është trajtuar me mbulesë me hark guri të punuar mirë. Absida është një thellim me seksion jo plotësisht gjysmë rrethorë, brenda trashësisë së murit i cili shërben edhe si mur ndarës i kapelës me sterën. Në krahun verior të absidës ndodhen të thelluarat e protezisit, të cilat kanë seksion gjysmë rrethor, më të vogël nga ai i absidës. Porta e hyrjes është e mbuluar me hark guri. Me gurë të punuar janë dhe shpatullat, ndërsa e tërë fasada perëndimore është e suvatuar. Shpatullat dhe korniza e dritareve janë me nga një bllok guri gëlqeror. Kjo kishë e vogël ka objekte të murosura të njohura si fenomeni "spoglia". Kështu në anën perëndimore ka një stelë varri. Stela e varrit ndoshta me origjinë nga Apolonia? Duhet sqaruar se nuk janë shenjtorë si jepet në disa libra por stelë varri të shek. III-II p. Kr. Në anën perëndimore janë të murosura një pllakëz me gurë gëlqerorë me temë nga amazonomakia. Po në këtë janë edhe dy stela votive, të cilat do t'i trajtojmë në vijim.



**Kisha e *"Shën Triadhës"***

## KISHA "LINDJA E SHËN MËRISË"

Afreskët murale janë vepër e artistëve Kostandin dhe Athanas Zografi, realizuara në vitin 1745. Ai përfshin muret anësore të sallës dhe faqen perëndimore të narteksit, me një program të pasur ikonografik nga historia e Dhjatës së Re. Piktura e ndarë në regjistra përbëhet nga kompozime katërkëndëshe, brezi ornamental me profetët dhe shenjtorët në këmbë me madhësi natyrale. Gjithashtu, programi ikonografik, në faqen lindore përfshin afresket e absidës, Shën Mërinë Platitera me Krishtin e vogël në prehër dhe anash saj, ëngjëjt me ilitot e hapura.



Kisha *"Lindja e Shën Mërisë"*

## KISHA E "FJETJA E SHËN MËRISË" NË FSHATIN BISHQETHËM

**Sipas një gojëdhëne: '*kisha mendohet të jetë ndërtuar në vitin 1198. Tregohet gjithashtu që kjo kishë u shkatërrua në vitin 1600 nga ushtarët turq. Më pas, aty nga viti 1750, kisha u rindërtuar me ndihmën e besimtarëve vendas mbi themelet e kishës së vjetër*'.**
Kjo kishë është e variantit të kishave të Myzeqesë, d.m.th. e përbërë nga Naosi dhe hajatet që e rrethojnë në tri anë. Naosi është i tipit bazilikal trenefësh, me përmasa të brendshme 16,75 x 8.50



Afreskë nga kisha e *"Fjetja e Shën Mërisë"*

## KISHA E "SHËN KOLLIT" NË FSHATIN KRUTJE E SIPËRME

**Për këtë kishë nuk dihet data e ndërtimit, por mendohet të jetë ndërtuar në mesin e shek. XVIII. Ajo është pikturuar në vitin 1811 (më 17 shkurt) nga Nikolla Çetiri nga Grabova.** Është e variantit të kishave të Myzeqesë, d.m.th. e përbërë nga Naosi dhe hajatet që e rrethojnë në tri anë. Naosi është i tipit bazilikal trenefësh, me përmasa të brendshme 15,75 x 8.70 m.



Pamje nga ana perëndimore e kishës

## KISHA E "SHËN KOLLIT" NË FSHATIN TOSHKËZ

**Kjo kishë siç tregon edhe data mbi portën hyrëse është ndërtuar në 1797. Kisha është pikturuar në vitin 1813 nga mjeshtrit Johan dhe Nikolla Çetiri nga Grabova.**
Është e variantit të kishave të Myzeqesë, d.m.th. e përbërë nga Naosi dhe hajatet që e rrethojnë në tri anë. Naosi është njënefësh, me përmasa të brendshme 11,80x6.40 m i mbuluar me çati dru



Pamje nga ana lindore e kishës

# KISHA E "SHËN TODRIT " NË FSHATIN KADIPASHAJ (ARRËZ)

Kjo kishë është pikturuar nga Johan Çetiri dhe nipi i tij Nikolla nga Grabova, në vitin 1801. Ndryshe nga shumë kisha të Myzeqesë, këtu pjesët përbërëse, naosi, narteksi dhe hajati, janë të dalluara nga njëra-tjetra. Naosi është i tipit bazilikal, me përmasa të brendshme 14x8,40m, i ndarë nga dy radhë kolonash druri në tre nefe. Kolonat janë të veshura me dërrasa. Ato janë të lidhura ndërmjet tyre me harkada në drejtimin gjatësorë. Edhe arkadat janë ndërtuar me strukturë çatmaje (me kallama).



**Pamje nga ana lindore e kishës.**

# MONUMENTE NATYRORE

## SELVITË E MANASTIRIT TË ARDENICËS



- Rrapi i Zonjës Bubullimë
- Lisi i Konjatit
- Dushkajat e Senës
- Burimi Termominerar Karbunarë
- Rrapi i Ngurëzës

## 2.5 KAPITALI NJERËZOR NË BASHKINË LUSHNJE

Sipas Censusit 2023 Shqipëria ka bërë zhvillime të rëndësishme në sistemin e saj arsimor, evidentuar ndër vite me norma të larta të alfabetizmit dhe normave të larta të ndjekjes së shkollës. Ky progres tregon dhe aftësinë e sistemit arsimor për t'i ofruar popullsisë mundësi të barabarta për mësim gjatë gjithë jetës.

Ekonomia e bashkisë së Lushnjes është përqendruar kryesisht te bujqësia dhe te blegtoria. Tregtimi i prodhimeve bujqësore kryhet përgjithësisht në tregun pranë qytetit të Lushnjës nga ku nisen edhe një pjesë e madhe e eksporteve bujqësore të Shqipërisë për tregjet në brendësi të Ballkanit apo në Europën qendrore e lindore.

Gjithashtu në zonat rurale ka banorë të cilët e ushtrojnë aktivitetin e tyre në mbareshtrimi e bagëtive të imta si lopët dhe delet, si dhe në prodhimin e nënprodukteve të qumështit. Në këto zona operojnë disa kompani të përpunimit të qumështit

Strukturat e punësimit në Lushnje kanë ndryshuar shumë ndër vite. Banorët kanë ndryshuar vendin e punës në raport me profesionin e tyre, si pasojë qytetarët kanë nevojë për njohuri të reja profesionale për t`ju përgjigjur sfidave të tregut të ri të punës.

Sa i takon zonës urbane, njësitë e shërbimit, tregtimit dhe subjektet e ndryshme private janë të vetmet burime të ardhurash për banorët e kësaj zone

## 2.6 KAPITALI SOCIAL NË BASHKINË LUSHNJE

Demografia e qytetit të Lushnjes përbëhet nga një popullsi homogjene e përbërë nga vendas dhe të ardhur nga rrethet si Skrapar, Berat etj, komunite Rome, Egjiptian etj. Popullsia është relativisht me transmetim të vlerave të larta shoqërore dhe edukatë qytetare. Është krijuar një edukate për transmetimin e vlerave kulturore nga një brez në tjetrin duke i perfeksionuar ato. Një pjesë e popullsisë së Lushnjes ka emigruar në dy vende kryesore Greqi dhe ne Itali si dhe në vende të tjera.

Bashkia Lushnje ka një larmi festash vendore si: Festa e Ardenicës në Njësinë Aministrative Kolonjë (martesa e Gjergj Kastriotit në Manastirin e Ardenicës, ku çdo vit kryhet rituali i kësaj martese), Festa e Ditës së Tokës, Festa e Ullirit në Njësinë Administrative Dushk, Festa e Qershive në Njësinë Administrative Ballagat, Festa e Tradidës Myzeqare në Fiershegan etj.

Lushnja me një popullsi afërsiht 63 135 banorë sipas Censusit 2023 dhe 132 068 banorë sipas RGJC ka një numër të konsiderueshëm punonjësish të arsimuar dhe me potencial të mirë për punë teknike, profesionale, administrative dhe politkëbërëse. Administrata e qytetit është një trupë me rreth 300 persona të arsimuar mirë në fushat e inxhinierisë, ekonomisë dhe juridiksionit, arsimit, planifikimit, etj.

## 2.7 KAPITALI I PRODHUAR NË BASHKINË LUSHNJE

Në territorin e Bashkisë Lushnje janë zbuluar shtresa naftëmbajtëse si ajo e Bubullimës si zgjatim i fushës naftëmbajtëse Patos – Marinëz dhe shtresa naftëmbajtëse në zonën Pekisht – Murriz. . Pjesë e kapitali natyror në Lushnje është stoku i burimeve natyrore si bimësia, uji, toka dhe biodiversiteti që gjenerojnë shërbime të ekosistemit për prodhimin e ushqimit. Gjithashtu, praktikat e menaxhimittë tokës dhe sistemet që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet, me vlerën e natyrshme dhe kapacitetin prodhues, përbëjnë një aset për t'u konsideruar dhe llogaritur.

## 2.8 KAPITALI FINANCIAR I BASHKISË LUSHNJE

Bashkia Lushnje ka një buxhet vjetor që arrin në 1,526, 521, 323 lekë. Ky buxhet është i përbërë nga transferta qeveritare (transferta e pakushtëzuar e përgjithshme) në vlerën 5 0 0, 7 7 3, 0 0 0 lekë. Buxheti nga transferta sektoriale është në vlerë 279,783, 000 lekë.

Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 26.5 % të totalit; taksa mbi tokën bujqësore e cila përbën 21.4 % të totalit, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e raja e cila përbën 18 % . të totalit.

Në vitin 2023, bashkia Lushnje ka realizuar në total 1,213,076 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 13 % ose 138,305 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në mijë lekë.

Tabela . Shpenzimet e bashkisë Lushnje sipas natyrës

| Shpenzimet e NJQV sipas natyrës | Realizimi faktik | | | | Diferenca | Raporti ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2023 | 2022 | 2021 | 2020 | 2023-2022 | |
| Shpenzime korrent | 1,023,847 | 980,282 | 864,155 | 892,336 | 43,564 | 4.44% |
| Personel | 694,616 | 592,106 | 579,651 | 563,387 | 10,511 | 1.78% |
| Operative | 329,231 | 399,177 | 284,504 | 328,949 | 58,946 | 15.20% |
| Të tjera | | | | | | |
| Shpenzime kapitale | 189,230 | 94,489 | 176,746 | 179,697 | 94,741 | 1% |
| **TOTALI** | **1,213,076** | **1,074,771** | **1,040,902** | **1,072,032** | **138,305** | **12.90%** |

## 2.9 SISTEMET T ERRITORIALE

Bashkia Lushnje me vendim të KKT-së nr. 4 datë 29.12.2016 në KKT ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor. Me vendim të KKTsë nr:2, datë:13.01.2020 është miratuar rishikimi këtij plani Plani i Përgjithshëm Vendor prezanton këtë sistem territorial, të ndarë në sisteme sipas tabelës më poshtë:

Tabela 3. Shpërndarja Urbane

| Sistemi | Të dhëna ekzistuese | | Të dhëna të propozuara | |
|---|---|---|---|---|
| | Sipërfaqe ha | % | Sipërfaqe ha | % |
| Urban -ub | 2455.9 | 6.59 | 2569.1 | 6.89 |
| Bujqësor b | 28811.8 | 77.3 | 27770.6 | 74.5 |
| nfrastrukturore in | 839.6 | 2.25 | 1273.42 | 3.42 |
| Natyror n | 4315.8 | 11.58 | 4764.46 | 12.79 |
| Ujor u | 848.9 | 2.28 | 894.44 | 2.4 |

# 3. IDENTIFIKIMI I BURIMEVE NATYRORE

## 3.1 BURIMET MINERARE

Bazuar në të dhënat e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, viti 2016, Bashkisë Lushnje disponon vendburime mineralesh jometalorë si argjila, alevrolite, gëlqeror, lithotamnik, ranor, konglomertae, inerte të ndryshme shfrytëzimi i të cilave ka rëndësi ekonomike për këtë bashki. Në pjesën jugore të këtij rajoni gjen zhvillim monoklinari i Patos -Marinzë- Bubullimë ku janë zbuluar rezerva nafte dhe gazi në zonën e Bubullimës.ndërsa në lindje të rajonit rezerva industriale nafte janë zbuluar në zonën e Murrizit.prania e këtyre shtratimeve naftëmbajtëse janë tregues që flasin për perspektivën në drejtim të kërkimit të hidrokarbureve në të ardhmen në këto rajone( SHGHSH).

# ENERGJIA

## ENERGJIA ME BAZË KARBONI

Në territorin e Bashkisë Lushnje janë janë kryer punime kërkimi me puse të thellë për naftë dhe gaz nga kërkimet është zbuluar vendburimi i naftës i Pekisht -Murrizit dhe janë zbuluar rezerva nafte e gazi në zonën e Bubullimës që është zgjatim i fushës naftëmbajtëse të Patos-Marinzës. Kjo zonë është e njohur për cilësinë dhe sasinë e lartë të hidrokarbureve.

## VENDBURIMI I NAFTËS PATOS – MARINËZ – BUBULLIMË

Ky vendburim ndodhet në pjesën jugore të rajonit të kësaj bashkie, në zonën e fshatrave Bubullimë-Halilaj- Eskaj

Tabela: Vendburimi i Patos -Marinëz – Bubullimë

| Nr | Lloji I rezervave | Rezervat në ton |
|---|---|---|
| 1 | Rezervat e llogaritura gjeologjike | 251907913 |
| 2 | Rezervat e nxjerra | 18669939 |
| 3 | Koeficienti i naftënxjerrjes | 7.41% e rez. gjeol. dhe 35.13 kundrejt të nxjerrshme |

Burimi SHGJSH

## VENDBURIMI I NAFTËS PEKISHT -MURRIZIT

Rajoni i Pekisht – Murrizit qysh herët ka tërhequr vëmendjen e gjeologëve për kërkimin e hidrokarbureve ku një rol të rëndësishëm kanë luajtur shenjat e naftës në sipërfaqe. Ky vendburim ndodhet në skajin lindor të rajonit të Bashkisë Lushnje dhe përhapjen më të gjerë e ka tej kufijve lindorë të këtij rajoni në zonën e Pekishtit që i përket Bashkisë së Peqinit.

Tabela: Vendburimi Pekisht - Murriz

| Nr | Lloji i rezervave | Rezervat në ton |
|---|---|---|
| 1 | Rezervat e llogaritura gjeologjike | 1970400 |
| 2 | Rezervat e nxjerrshme | 1967040 |
| 3 | Rezervat e nxjerra | 17160.9 |


Burimi SHGJSH

## GËLQERORËT

Gëlqerorët kanë përhapje të kufizuar në rajonin e bashkisë Lushnje në ngritjen Karbunarë- Lushnje. Në fshatrat Karbunarë dhe Stan – Karbunarë ndodhen karrierat më të vjetra të vendit tonë të hapura që prej vitit 1960, ku këta gëlqerorë janë shfrytëzuar nëpërmjet guroreve të hapura..

## VENDBURIMI STAN KARBUNARË GURI GËLQEROR

Harta në GIS e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore na jep të dhëna për këtë vendburm. Rrezervat gjeologjike të gurit gëlqeror janë 100000 $m^3$ të një cilësie 45.42% - 54.64% CaO dhe e marrë prodhimin minmal është 10000 $m^3$




Burimi AKBN

Tabela e objekteve gëlqerorë

| Nr | Lloji | Rezervat në $m^3$ |
|---|---|---|
| 1 | **Rezerva gjeologjike** | **100000** |
| 2 | Prodhimi minimal | 10000 |
| 3 | Cilësia | 45.42% - 54.64% |

## ARGJILAT

Në territorin e kësaj bashkie këto depozitime gjejnë përhapje në zonat Allprenaj, Lekaj, Balaj dhe Zgjanë.
Në veri të Allprenaj, Virovë ka qenë hapur karriera nga ku merrej lënda e parë për fabrikën e tullave e cila fillimisht ndodhej pranë qytetit por për shkak të ndotjes u zhvndos afër vendburimit. Aktualisht kjo fabrikë është inekzistente.. Depozitimet argjilore të formacioneve të përmendura më lart janë të përshtatshme për prodhime qeramike duke i përdorur me përzierje rëre dhe duke bërë stazhionimin e argjilës.

Tabela e objekteve argjilave

| Nr | Venburim ose Shfaqje | Rezervat në $m^3$ |
|---|---|---|
| 1 | Virovë | 4 729 000 |
| 2 | Kasharaj | 973 100 |
| 3 | **Totali** | **5 702 100** |

Burimi SHGJSH (2016)

# ENERGJIA E RINOVUESHME

## ENERGJIA DIELLORE

Bashkia Lushnje ka një sipërfaqe 379.58 $km^2$ të shtrirë në një terren fushor dhe kodrinor. Orët me diell janë rreth 2 500 – 2700 orë/vit. Temperatura mesatare luhatet 15°-16° C. Nuk ka erëra me shpejtësi të madhe , pjesa lindore ka erëra me shpejtësi 1.5 -2 m/s kurse pjesa perëndimore ka erëra me shpejtësi 2.6-3 m/s dhe pjesa qendrore ka erëra me shpejtësi 2.1-2.5 m/s. Territori i bashkisë ka potencial për shfrytëzimin e energjisë diellore nëpërmjet paneleve fotovoltaikë.
Gjatë vitit 2022 sipas të dhënave të AKBN ka hyë në prodhim subjekti AEE shpk me vndndodhje fshati Plug, Njësia Administrative Golem i cili prodhon energji elektrike nga centralet fotovoltaike.
Aktualisht në territorin e kësaj bashkie janë duke u ndërtuar panelet fotovaltieke ( Ndërtimi i Centralit Fotovoltaik 10MW "5GX ENERGY SOL PARK") nga 5GX ENERGY shpk në Fshatin Allprenaj, njësia Administrative Fiershegan.

| Nr | Centrali fotovoltaik | MW | Lidhja | Prodhimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | AEE shpk | 2 | 10 | 4,516 |

Prodhimi energjisë nga subjekti AEE shpk

## 3.2 BURIMET UJORE

### UJËRAT SIPËRFAQËSORË

Territori i bahkisë Lushnje përshkohet në pjesën jugore të saj nga Lumi Seman i cili ka një gjatësi 281 km dhe prurje mesatare 95.7 m/s dhe në veri nga Lumi Shkumbin i cili ka një gjatësi 181 km dhe prurja e ujit arrin vlerën 61 m/s që kalon në një pjesë të territorit të saj. Gjithashtu territori i bashkisë përshkohet nga një rrjet i pasur me kanale ujitëse dhe kulluese të cilët furnizoheshin nga 15 rezervuarë të ndodhur në territorin e bashkisë si Garunjas, Balaj., Manasufaj, Kurtinë, Lekaj, Çanakaj, Ksharaj, Pajalli, Skilaj, 2 në Njësinë Administrative Dushk, 2 në Njësinë Administrative Golem, dhe 2 në Njësinë Administrative Kolonjë.

### UJËRAT NËNTOKËSORE

Në Bashkinë e Lushnjes akuiferët ndërkokrrizor vlerësohen me ujëmbajtje shumë të lartë – të lartë, dhe paraqesin rëndësi të madhe në furnizimin e qendrave të banuara me ujë të pjshëm Bashkia ka resurse ujore nëntokësore të mëdha që shërbejnë për furnizimin e popullsisë së bashkisë dhe zonave përreth saj. Akuiferi më irëndësishëm është akiufer që shtrihet nga lumi Shkumbin deri në ish kënetën e Tërbufit

Stacioni i pompave Çinar është një shpim i vjetër me thellësi 70 m dhe furnizon 6 fshatra. Stacioni i pompimit Dushk me një thellësi shpimi 15 m furnizon vetëm fshtain Dushk. Stacioni i pompimit Konjat është një nga stacionet më të rëndësishme në këtë zonë për shkak edhe të sasisë së madhe të ujit që shfrytëzohet prej tij. (SHGJSH)

Tabela Prurjet

| Nr | **Vendndodhja** | **Sasia që shfrytëzohet (l/s)** |
|---|---|---|
| 1 | Stacioi i pompave Çinar | 27 |
| 2 | Stacioi i pompave Kolonjë | 5 |
| 3 | Stacioi i pompave Konjat | 300 |
| 4 | Stacioi i pompave Plug | 10 |
| 5 | Stacioi i pompave Dushk | 15 |
| **Totali** | | **357** |

Burimi SHGJSH

## 3.3 ATRAKSIONET TURISTIKE

### TURIZËM KULTUROR

### SHTËPIA KONGRESI I LUSHNJES

Shtëpia ku u mbajt mbledhja e Kombit e njohur si "Kongresi Lushnjes", është ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit të XIX. Kjo shtëpi është e tipit beratase me dy kate, ndërsa në çati ka një dhomë të vogël të quajtur ndryshe "Konaku i Hankove". Shtëpia "Kongresi Lushnjes" u hap si shtëpi muze në 21 Janar 1960.

### MUZEU HISTORIK LUSHNJE

Ideja për ngritjen e Muzeut Historik, daton në vitin 1982. Në dokumente, thuhej ndër të tjera se, vendi ku do të ndërtohej muzeu duhej të ishte pranë qendrës dhe buzë rrugës. Muzeu ka një arkitekturë bashkëkohore dhe të ndryshme nga ndërtesat e tjera të qytetit, dhe pasqyron historinë e qytetit të Lushnjes nga lashtësia, ka dhe një hapsirë të veçantë kushtuar Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Gjithashtu ka një kënd të veçantë kushtuar Arkeologjisë, Etnografisë, etj. Zyrtarisht Muzeu u përurua më 21 Nëntor 1990

### MANASTIRI I ARDENICËS

Manastiri ndodhet në zonën e Ardenicës, njësia Administrative Kolonjë.Studiuesit më në zë të monumenteve të kulturës në Shqipëri theksojnë se manastiri është ndërtuar në mesjetën e mesme. i ndërtuar në një vend dominues, në kreshtën e kodrave të "Ardenicës", pamja që ofrohet për vizitorin është mbresëlënëse. Prej këtu, në perëndim mund të dallosh lehtësisht bregun e detit, lagunën e Karavastasë, fushat e pafund të Myzeqesë dhe malet e larta në lindje. Sapo kalon pragun e portës së rëndë menjëherë përballesh me një vepër të veçantë arkitekturore. Ku në qendër është kisha e madhe, kapela dhe konaket që e rrethojnë. Teksa futesh në tempull mrekullohesh me afreskët shumë ngjyrësh të pikturuara nga mjeshtrit më të dëgjuar të Mesjetës

### KISHA E SHËN KOLLIT KRUTJE

Kisha ndodhet në zonën e Krutjes së Sipërme , Njësia Administraive Krutje. Hyrjet e kishës janë hapur nga ana perëndimore ndërmjet dy dritareve, në anën veriore dhe jugore. Si zakonisht, pjesa perëndimore e hajateve është më e gjerë. Në një fazë më të vonë, në vitin 1924 është ndërtuar një ambient ndenjeje me dysheme më të ngritur dhe i pajisur me oxhak. Hyrjet për në hajatet janë hapur gjithashtu në anën perëndimore, jugore dhe veriore, përballë atyre të naosit. Porta perëndimore është hapur në katin përdhe të kullës së kambanores dhe ka përpunim më dekorativ, në formë harku me gurë të latuar. Kulla e kambanores që lartësohet në pjesën perëndimore është ndërtuar në vitin 1924.

### KISHA E SHËN KOLLIT TOSHKËZ

Kisha ndodhet në zonën e Toshkëzit në Njësinë Administrative Allkaj. Në brendësi është e pajisur me një tavan dërrase, i cili përmban tre thellime, nga të cilët ai qendrori është më i madh. Ikonostasi prej druri të gdhendur, ndan ambientin e altarit, i cili përmban absidën qendrore e të nxjerrë jashtë të bemës dhe niket e shërbesës për protezisin dhe diakonikonin. Brendësia ndriçohet bollshëm nga dritare të mëdha, të hapura në pjesët e sipërme të mureve veriore dhe jugore. Në anën veriore, jugore dhe perëndimore naosi rrethohet nga hajatet, si zakonisht pjesa perëndimore e hajateve është më e gjerë. Këtu janë vendosur katër radhë kolonash druri që mbajnë çatinë. Hajatet nuk kanë tavan. Hyrjet për në hajatet janë hapur në muret perëndimore dhe jugore, karshi hyrjeve të naosit. Në pamje të jashtme volumi i naosit i mbuluar me çati dyujëse mbizotëron mbi volumet e ulëta të hajateve. Pjesët veriore dhe jugore të hajateve mbulohen me çati njëujëse, ndërsa ajo perëndimore me çati triujëse. Mbi frontin e murit perëndimor të naosit ngrihet kambanorja me hapësira të harkuara për kambanat. Muratura e naosit është ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje dhe është e suvatuar me një shtresë të hollë llaçi. Absida në anën lindore është ndërtuar me gurë të skalitur, të cilët janë të qarkuar me tulla të vendosura në formë dhëmbësh sharre ndërmjet rreshtave të drejtë. Mbulesat e dritareve janë të rrafshëta, ndërsa ato të dyerve të harkuar.

